



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KRUJË

Nr. 272 Akti  
Datë 14.10.2019 Regjistrimi

Nr. 272 Vendimi  
Datë 16.12.2019 Vendimi

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, e përbërë prej :

**GJYQTARE - Engjëllushe TAHIRI**

asistuar nga sekretare gjyqësore Rukije DERVISHI sot më datë 16.12.2019 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore kërkesën penale që i përket:

**KËRKUES:** Shkëlzen Hoxha, i biri i Naim dhe i Mevlude, i datëlindjes 16.03.1976, lindur e banues në Krujë, me arsim të lartë, i martuar, me shtetësi e kombësi Shqiptare, përfaqësuar në gjykim nga avokat Qazim MENECI me deklaram në seancë gjyqësore.

**KUNDËR:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë përfaqësuar në gjykim nga Prokurori Bujar MEMIA.

**OBJEKTI:** Heqjen e sekuestros konservative vendosur me vendimin nr.214 datë 09.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 274 i K.Pr.Penale.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata pasi:

- administroi provat bashkëngjitur kërkesës,
- dëgjoi mbrojtësin e palës kërkuese që kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit;
- dëgjoi Prokurorin që kërkoi rrëzimin e saj;
- shqyrtoi aktet dhe çështjen në tërësi.

**VËREN SE :**

Pala kërkuese ka paraqitur për shqyrtim kërkesën penale sipas objektit dhe bazës ligjore të lartpërmendur.

**RRETHANAT E FAKTI**

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ka regjistruar procedimin penal nr.565 viti 2015 që bën fjalë për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës", "Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën" dhe "Shpërdorimit të kontributeve të dhëna nga shteti" parashikuar nga nenet 248, 135-25 dhe 256 të kpenal, mbi bazën e kallzimit

penal të paraqitur nga ana e Bashkisë Krujë ndaj ish Kryetarit të Bashkisë Shkëlzen Hoxha dhe personave të tjerë. Kallzimi penal është bazuar në ankesën e një grupi banorësh në lagjen nr. 1 të qytetit Krujë lidhur me sistemin e përroit në këtë lagje. Në kallzimin e saj Bashkia Krujë pretendon se nga ana e ish kryetarit të Bashkisë është nënshkruar një kontratë për zbatimin e punimeve në objektin "Sistemi i përroit lagjia nr. 1 Ura e Madhe Krujë me vlerë 20.520.000 lekë". Afati për përfundimin e punimeve ka qenë dy muaj, sipas dokumentacionit të ndodhur në Bashki ky objekt ka përfunduar ndërkohë realisht një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Për këtë procedim penal është dhënë vendimi nr.214 akti datë 09.06.2016 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me të cilin është vendosur sekuestrimin në çdo lloj banke të Republikës së Shqipërisë të depozitave që disponon i pandehuri Njazi Prençi, si person fizik, shtetasi Shkëlzen Hoxha etj. Me vendimin penal nr.134 datë 04.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Krujë është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit Shkëlzen Hoxha për veprën penale të "Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën" kryer në bashkpunim parashikuar nga neni 135 dhe 25 i kodit penal dhe dënimin e tij me dy vite burgim, aplikimin e nenit 59 të kodit penal duke pezulluar ekzekutimin e vendimit të dënimit me burgim për një periudhë prej katër vitesh. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin penal nr.631 datë 08.05.2019.

Përmes kërkesës objekt gjykimi pala kërkuese kërkon heqjen e sekuestros së vendosur me vendimin penal nr.214 akti datë 09.06.2016 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë. Ndërsa Prokurori nuk ishte dakort me këtë kërkesë.

#### ANALIZA JURIDIKE

Nga sa më sipër, bazuar në aket dhe provat e shqyrtuara në seancë Gjykata në marrjen e vendimit ka parasysh nenet 274 e vijues të kprpenale në të cilët sanksionohet se : "1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron." (Neni 274)

"1. Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t'i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojnë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qenë prodhim ose përfitim nga vepra penale. 2. Kur është dhënë vendimi i dënimit, efektet e sekuestros vazhdojnë në rast se është vendosur konfiskimi i sendeve të sekuestruara.3. Sendet e sekuestruara nuk kthehen kur gjykata vendos që të mbahet sekuestroja për garantimin e kredive." (Neni 275)

"1. Kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros cilido që ka interes mund të bëjë ankim. 2.Kërkesa e ankimit paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë. 3.Kërkesa paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin. 4. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës. 5.Mbi kërkesën e ankimit vendos gjykata e apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve. 6. Gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit të ankimuar. 7.Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, vendimi për vënien e sekuestros e humbet fuqinë." (Neni 276)

Në interpretim të këtyre dispozitave Gjykata sqaron se sekuestroja preventive është një llojet e masave të sigurimit pasuror, objekt i së cilës janë sendet që lidhen me

veprën penale disponimi i lirë i të cilave mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, sendet të cilat janë produkt i veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. Vendimi për caktimin e kësaj mase sigurimi, sikundër edhe për masat e tjera të sigurimit pasuror/personal zëvendësohen/hiqen në momentin që ndryshojnë edhe kushtet e caktimit të tyre. Kundër vendimit të Gjykatës mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit nga cilido person i interesuar.

Në rastin objekt gjykimi, rezultoi se për llogari të procedimit penal nr.565 viti 2015, për të cilën kërkuese ka qenë duke u hetuar për veprën penale të "Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën" kryer në bashkpunim parashikuar nga neni 135-25 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin penal nr.214 akti datë 09.06.2016 ka vendosur sekuestrimin në çdo lloj banke të Republikës së Shqipërisë të depozitave që disponon i pandehuri shtetasi Shkëlzen Hoxha. Në këtë vendim nuk janë përcaktuar depozitat konkrete të cilat duhet të ishin sekuestruar, sikundër pala kërkuese nuk dorëzoi gjatë gjykimit procesverbalin e ekzekutimit të këtij vendimi nga ana e Prokurorisë së Rrethit Krujë, nuk specifikoi sasinë e të hollave që janë sekuestruar dhe nuk argumentoi ligjërisht kërkesën e tij në këndvështrim të faktit se me vendimin penal nr.134 datë 04.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Krujë është vendosur deklarimi fajtor i tij për veprën penale të "Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën" kryer në bashkpunim parashikuar nga neni 135 dhe 25 i kodit penal, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin penal nr.631 datë 08.05.2019. Gjykata ndodhet në pamundësi për të evidentuar kërkimin konkret dhe interesin që pretendohet t'i jetë cënuar palës kërkuese pasi nuk mund të hulumtojë mbi faktin nëse vendimi gjyqësor nr.214 akti datë 09.06.2016 është ekzekutuar në ndonjë momento kohor dhe nëse po si është kryer ekzekutimi i tij, cilat janë llogaritë bankare që janë sekuestruar, cila është shuma e tyre dhe lidhja me veprën penale për të cilën është dënuar pala kërkuese.

Pasur parasysh rrethanat e faktit të konstatuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, provat e aktet shkresore të administruara në seancë si dhe arsyetimin ligjor të lartpërmendur, Gjykata çmon se kërkesa nuk është e bazuar në ligj e prova,

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 274 e vijues të K.Pr.Penale,

### VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesës pasi është e pabazuar në ligj dhe në prova.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afait ligjor.
4. U shpall në Krujë më datë 16.12.2019.

SEKRETARE  
Rukije DERVISHI



GJYQTARE  
Engjëllushe TAHIRI



**SHENIM dt.10.03.2020**

-Kunder vendimit te Gjykates se Rrethit Kruje kane paraqitur ankim kerkuesi Shkelzen Hoxha dhe Gjykata e Apelit Tirane me vendimin nr.45 date 16.01.2020 ka vendosur:

-Lenien ne fuqi te vendimit nr.272 date 16.12.2019 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kruje.

-Kunder ketij vendimi lejohet rekurs ne Gjykatën e Larte, brenda 45 diteve nga e nesermja e shpalljes se vendimit.

**KANCELARI**

**ARGJEND QESJA**

